

## AKT - THEMELIMI

SHOQERISE TREGTARE me PERGJEGJESI te KUFIZUAR

### “Hotel - VICTORIA”

Ne baze te ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, ligjes Nr 7632 date 04.11.1992 “Per dispozitat qe rregullojne Kodin Tregtare”, une Luan MATA, i biri i Zeqirit dhe Anifes, lindur me 01.05.1960, banues ne Tirane, rruga e “Dibres” Nr 445, sot me date 01.09.2006, vendosa te krijoj Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “Hotel - VICTORIA”, me ortak te vetem Luan MATA.

### HYRJE

Gjykata e Rrethit Tirane, me vendimin Nr 11527, date 03.09.1999, ka pranuar kerkesen dhe ka vendosur : Regjistrimin person fizik te kerkuesit Luan MATA, per te ushtruar aktivitet privat e tregtare ne fushen e Hotelerise, bar-restorant, tregetimin me shumice e pakice per mallra te ndryshem ushqimore dhe produkte bujqesore e blektorale. Aktivitet te cilin vazhdoj ta ushtroj. Duke qene se organet tatimore e kane klasifikuar ne grupin e biznesit te madh ku edhe e kane regjistruar vendosa ta regjistroj ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Tirane ne cilesine e Personit Juridik. Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “Hotel - VICTORIA”.

Ortaku i vetem ka te drejta dhe detyrime qe rrjedhin nga veprimtaria e Shoqerise. Qellimi i ketij Akti eshte themelimi i Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “Hotel - VICTORIA”.

### OBJEKTI

Objekti i veprimtarise i Shoqerise Tregtare “Hotel - VICTORIA” sh.p.k. eshte :

- Sherbime ne hoteleri, ushqim social, restorant, bar-kafe.

- Organizimi i grupeve dhe i udhetimeve(guidave) turistike, brenda e jashte vendit.

- Eksport e import, Tregtimi me shumice dhe pakice i :

- Mallrave industriale, lende te para, produkte industriale, tekstile, veshje, konfeksione, prodhime galanterie, bizhuteri, argjendari, lodra per femije, te cdo lloi.

- Mallrave ushqimore, prodhime bujqesore e blektorale te fresketa e te perpunuara, pije alkolike e freskuese, sapun, shampo, detergente, te cdo lloi.

- Prodhime metalike e konstruksione te cdo lloi, Automjete, makineri e paisje per bujqesine, pjese kembimi, goma, vajra e lubrifikante.

- Paisje e orendi elektroshtepiake, paisje elektronike, materiale elektrike, hidraulike, hidrosanitare, materiale ndertimi, te cdo lloi.



Prodhime druri, mobileri, tapiceri, dyer, dritare, aksesore per to etj.

Transport automobilistik e te kombinuar te mallrave dhe udhetareve brenda e jashte vendit, me mjetet e veta ose te te treteve, per vehte e te trete. Agjenci per tregetimin e biletave per transport te cdo lloji per brenda e jashte vendit.

Zyre konsultimesh biznesi, asistence tekniko financiare, agjensi per shitjen e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.

## SELIA

Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar "**Hotel - VICTORIA**" sh.p.k. do te kete seline e saj ne Tirane, rruga e "Dibres" Nr 445.

## AFATI

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Tirane.

Per shkaqe e arsye te ndryshme, ajo mund te mbaroje aktivitetin e saj dhe para ketij afati. Kjo do te behet ne perputhje me normat e Statutit dhe legjislacionit ne fuqi.

## KAPITALI THEMELORE I SHOQERISE

Kapitali baze i themelimit te Shoqerise perbehet nga kapitali themelore i investuar nga ortaku i vetem Luan **MATA** dhe eshte 100.000 leke.

Ortaku i vetem eshte pergjegjes ndaj Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar per te gjitha detyrimet e marra persiper dhe pergjigjet per humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltare.

Fondet monetare te Shoqerise mund te perdoren per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise se saj ekonomike-financiare.

## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te administrohet nga ortaku i vetem qe do te jete edhe Administratori i saj z. Luan **MATA**, ne perputhje me Statutin dhe dispozitat respektive te Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise jane percaktuar ne Statutin e Shoqerise tregetare private "**Hotel - VICTORIA**" SH.P.K. qe shoqeron kete **Akt Themelimi**.

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridik e fizik, vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane.




Ky **Akt Themelimi** perpilohet ne kater kopjo. duke patur sejcila kopje fuqi te plote ligjore dhe nenshkruhet rregullisht nga Ortaku i Vetem themelues z. Luan MATA. me vullnetin e tij te lire e te plote.

Nga keto. nje kopjo do te depozitohet ne zyren e Noterise. nje kopjo ne Regjistrin Tregtare te gjykates. nje kopjo ne Zyren e Tatim Taksave Tirane ndersa nje kopjo mbetet ne dokumentacionin baze ne seline e shoqerise.

Tirane, me 01.09.2006

## ORTAKU I VETEM THEMELUES

Luan MATA





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1792 Rep  
Nr. 894 Kol.

### VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 01.09.2006 (dymije e gjashte ) para meje notere Shkendie **SHAHU**. me seifi ne rrugen e "Durrësit" u paraqit personalisht shtetasi Luan **MATA**. me identitetin e tije u sigurova nga pasaporta personale Z. 1577380. Ne moshe madhore. me zotesi te plote juridike edhe per te vepruar. i cili deklaroi se ne Aktin e Themelimit te Shoqerise Tregtare "**Hotel – VICTORIA**" sh.p.k.. si me lart shprehen vullneti i tije te plote dhe te lire dhe e firmosen ate para meje. ku une noterja e vertetoj sipas ligjes.



**STATUTI**  
**i**  
**SHOQERISE TREGTARE me PERGJEGJESI te KUFIZUAR**

**"Hotel - VICTORIA"**

**HYRJE**

**NENI 1**

Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar **"Hotel- VICTORIA"** sh.p.k. krijohet mbi bazen e iniciatives dhe kapitalit themelore te Ortakut te Vetem, z. Luan **MATA**, i biri i Zeqirit dhe Anifes, lindur me 01.05.1960, banues ne Tirane, rruga e "Dibres" Nr 445 Madhore e me zotesi te plote juridike edhe per te vepruar

Ne baze te Aktit te Themelimit te shoqerise tregtare **"Hotel- VICTORIA"** sh.p.k. date 01.09.2006, per te ushtruar aktivitetin e saj si person juridik i pavarur

**NENI 2**

Shoqeria krijohet dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij Statuti, Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise

**NENE 3**

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltare

**KOHEZGJATJA, EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI**

**NENI 4**

Emertimi i Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar eshte **"Hotel- VICTORIA"**.

**NENI 5**

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar **"Hotel- VICTORIA"** ka seline e saj ne Tirane, rruga e "Dibres" Nr 445

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne Tirane, mund te shtrihet ne te gjithe territorin shteterore te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj duke respektuar ligjet e atij vendi

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**NENI 6**

Objekti i veprimtarise i Shoqerise Tregtare **"Hotel - VICTORIA"** sh.p.k. eshte Sherbime ne hoteleri, ushqim social, restorant, bar-kafe

Organizimi i grupeve dhe i udhetimeve/guidave turistike, brenda e jashte vendit.



Eksport e import Tregtimi me shumice dhe pakice i Mallrave industriale, lende te para, produkte industriale, tekstile, veshje, konfeksione, prodhime galanterie, bizhuteri, argjendari, locra per femije, te cdo lloi.

Mallrave ushqimore, prodhime bujqesore e blektorale te fresketa e te perpunuara, pije alkoholike e freskuese, sapun, shampo, detergjente, te cdo lloi.

Prodhime metalike e konstruksione te cdo lloi, Automjete, makineri e paisje per bujqesine, pjese kembimi, goma, vajra e lubrifikante

Paisje e orendi elektroshtepiake, paisje elektronike, materiale elektrike, hidraulike, hidrosanitare, materiale ndertimi, te cdo lloi.

Prodhime druri, mobileri, tapiceri, dyer, dritare, aksesore per to etj.

Transport automobilistik e te kombinuar te mallrave dhe udhetareve brenda e jashte vendit, me mjetet e veta ose te te treteve, per vehte e te trete, Agjenci per tregtimin e biletave per transport te cdo lloji per brenda e jashte vendit

Zyre konsultimesh biznesi, asistence tekniko financiare, agjensi per shitjen e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.

#### **NENI 7**

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit ne regjistrin tregtare te Gjykates Rrethit Gjyqesore Tirane. Per shkaqe e arsye te ndryshme, ajo mund te mbaroje aktivitetin e saj dhe para ketij afati. Kjo do te behet ne perputhje me normat e Statuti dhe legjislacionit ne fuqi.

### **KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE**

#### **NENI 8**

Kapitali themeltare i shoqerise perbehet nga kontributi i Ortakut te Vetem, z. Luan **MATA**, me shumen 100.000 (njeqind mije) leke

#### **NENI 9**

Kapitali themelore depozitohet para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

#### **NENI 10**

Kapitali themelore mund te shtohet ose zvogelohet, ne vartesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi. Ai mund te jete ne leke ose ne valute te huaj

#### **NENI 11**

Kapitali themelore mund te trasferohet jashte shoqerise, ose te lihet peng, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### **NENI 12**

Kapitali themelore eshte lehtesisht i transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortja, paraardhesi mund te behet ortak ne shoqeri nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit dhe sipas kushteve te parashikuara me ligj

#### **NENI 13**



Shoqeria mund te kete dhe kontribute te tjera ne natyre. Ketu përfshihen te gjitha sendet e pajueshme ne shërbim te shoqerise si dhe ato te luajtshme, te cilat kalojne ne pronesi te shoqerise

## **FONDET E SHOQERISE**

### **NENI 14**

Shoqeria percakton fonder

- Fondi themeltare (qarkullues).
- Fondi rezerve
- Fonde te tjera qe mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Madhesia e seicilit fond percaktohet mbi bazen e vendimit te organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe per qellimin e perdorimit te tije

## **DREJTIMI ADMINISTRATIV**

### **NENI 15**

Shoqeria ka si organe drejtuese :

- Asambleja e Ortakeve, ne rastin konkret eshte Ortaku i Vetem.
- Administratori, Ortaku i Vetem eshte z. Luan **MATA** i cili eshte njekohesisht dhe Administrator i shoqerise

### **NENI 16**

Ortaku i Vetem per administrimin e shoqerise ose te aktiviteteve te vecanta te saj ka kompetence te emerije nje ose disa persona te tjere si administrator te shoqerise. Kompetencat e administratoreve te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre te leshuar nga ortaku i vetem.

### **NENI 17**

Shoqeria nuk merr persiper veprimet qe mund te kryejne administratore te tjere te mundshem, ne marredhenje me persona te trete qe i tejkalojne kompetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.

### **NENI 18**

E gjithë veprimtaria e shoqerise percaktohet nga administratori i saj ne perputhje me Statutin dhe legjislacionin ne fuqi

### **NENI 19**

Administratori per te shqyrtuar bilancin vjetore, te ardhurat e qarkulluara, si dhe menyren e mbajtjes se regjistrave te veprimeve kontabel, emerion nje ose disa eksperte kontabel. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara me lig;

## **KOMPETENCAT e ORTAKUT te VETEM**

### **NENI 20**

Per sa kohe qe shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem, kompetencat e tije do te jene,



Vendos per ndryshime ne Statutin e Shoqerise dhe miraton rregulloret per sektoret e vecante te sa:

Emeron dhe shkarkon administratoret dhe percakton kompetencat e tyre ne aktin e emerimit

Shqyrton bilancin vjetore, kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar

Vendos per krijimin e filialeve, degëve ose perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa

Vendos per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e aktivitetit te shoqerise, nese ne dokumentacionet financjare rezultatet e shoqerise vleresohen me humbje

Realizon marrdhenjet me te rendesishme financjare dhe ekonomike te shoqerise me persona te tjere fizik dhe juridike

## KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

### NENI 21

Administratori i shoqerise ka per detyre

- Te punoje te drejtoje e te organizoje ne menyre te tile qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomike financjare
- Te zbatoje vendimet e marra nga ortakut dhe urdherat e tij, te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga Statuti i Shoqerise dhe legjislacioni ne fuqi.
- Te paraqese ne menyre te rregullt raportin e administrimit te inventarit, bilancit dhe te llogarive vjetore, ortakut brenda nje afati 6 muaj pas mbylljes se vitit financjare pasardhes
- Realizon dhe percakton cmimet e punimeve te kryera se dhe te shitjeve te artikujve te tregtuar
- Vendos per pagat e personelit te shoqerise.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marrdhenje me organet te ndryshme shteterore dhe me persona te tjere fizik dhe juridike.

## MARRDHENJET FINANCJARE

### NENI 22

Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar "Hotel - VICTORIA" sh.p.k mund te lidhe kontrata me sektore shteterore, drejtperdrejte me tregun e lire, si dhe me persona fizik e juridik, vendas ose te huaj.

### NENI 23

Ne marrdhenjet kontraktore, shoqeria perfaqesohet nga ortakut i vetem ose nga persona te autorizuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

### NENI 24

Shoqeria ka te drejte te plote te cele llogari likujduese prane Bankave te vendit ose te huaja ne Shqiperi, shteterore ose private dhe te kryej veprimet e likujdimit nepermjet tyre. Per sigurimin e veprimtarise ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose ne valute te huaj

### NENI 25



Shoqeria pergjigjet per kontributet fiskale, afatet e derdhjes se tyre dhe sigurimet shoqerore. Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacion te rregullt financjare. Administratori ne fund te vitit duhet te dorezoje ne organin tatimore perkates bilancin e te archurave per efekt te tatimit vjetore.

Viti financjare mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore nenshkruhen nga ortaku i vetem ne perputhje me dispozitat e ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi.

## **MARREDHENJET E PUNES**

### **NENI 26**

Ortaku i vetem vendos per personat qe do te punesohen ne aktivitetin e shoqerise. Punesimi do te benet ne perputhje me aftesite profesionale te punemarresit.

### **NENI 27**

Marredhenjet e punesimit rregullohen sipas kontrates se punesimit qe lidhet midis paieve, ne baze te Kodit te Punes dhe akteve ligjore e nenligjore ne fuqi. Ne kontrate caktohen kushtet e punes, te pageses, sigurimit ne pune, diteve te pushimit etj.

### **NENI 28**

Administratori dhe personeli i shoqerise eshte i detyruar te respektojte disiplinën e punes, te ruaj dhe mirembaje pronen dhe te zhvilloje aktivitetin e shoqerise ne perputhje me ligjen.

### **NENI 29**

Ndaj shkeljeve te ndryshme zbatohen masa disiplinore qe merren nga ortaku i vetem. Punonjesit qe largohen nga puna duhet te bejne dorezimin e detyres ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

## **PERGJEGJESIA E PUNONJESIT**

### **NENI 30**

Cdo punonjes i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushe detyrimet qe mjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i shoqerise. Per shkelje te tilla dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi merren masa te ndryshme sipas ligjit.

## **KONFIDENCIALITETI**

### **NENI 31**

Te gjithe personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne fshehtesine e dokumentacionit te informacionit, te njohurive te fituara si dhe te cdo lloj materiali tjeter konfidencial.

Ata duhet te adaptojne te gjitha masat e nevojeshme per te parandaluar hapjen e ketyre qofte edhe pjeserisht.





## **BILANCI DHE TE ARDHURAT**

### **NENI 32**

Te ardhurat neto, pas shlyrjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore dhe detyrimeve te mundeshme ndaj personave te trete, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem z.Luan MATA, i cili mund ti depozitoje ne nje banke te vendit ose te huaj, ne leke ose valute

### **NENI 33**

Pagesat e personelit behen sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e punes

### **NENI 34**

Ne rast te mbarimit te veprimtarise se shoqerise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar pergjindjet e mbartura nga vitet e mepareshme, kalojne ne dispozicion te ortakut te vetem z Luan MATA.

### **NENI 35**

Çmimet e sherbimeve te afuara nga shoqeria si dhe ato te tregetimit caktohen ne baze te parimeve te ekonomise se tregut te lire. Fitimet e realizuar i nenshtrohen tatimit vjetore te percaktuara ne dispozitat perkatese ligjore

## **SHPERBERJA E SHOQERISE**

### **NENI 36**

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues, ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimpruresi si dhe per shkaqe te parashikuara me ligj

### **NENI 37**

Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit, nepermjet formave te thithjes ose bashkimit

### **NENI 38**

Gjate fazes se likuidimit, pergjegjesia e administratorit dhe likuidatorit eshte e njerete

## **DISPOZITA TE FUNDIT**


### **NENI 39**

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut ose shoqeri sigurimesh.

### **NENI 40**

Mesmarreveshjet ne marredhenje me persona juridike e fizik, vendas ose te huaj zgjidhen me mirkuptim, ne te kundert, gjykate kompetenete eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane

### **NENI 41**



Cdo gje tjete ne kete Shoqeri i referohet Ligjes Nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptare

#### NENI 42


Shoqeria ka vulen e saj forma dhe permbajtja e se ciles percaktohet nga ortaku i vetem i shoqerise. Cdo akt qe del ne emer te shoqrise do te mbaje vulen e saje

Statuti i Shoqerise Tregtare "**Hotel- VICTORIA**" sh.p.k.u perpilua ne kater kopje te njejta. nga te cilat nje kopje depozitohet tek noteri, nje kopje ne regjistrin tregtare te Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane, nje kopje ne organet tatimore dhe nje kopje ruhet ne seline e shoqerise pasi u miratua dhe u nenshkrua rregullisht nga Ortaku i Vetem dhe Administratori i saj z. Luan **MATA**.

Tirane, me 01.09.2006

**ORTAKU I VETEM**

Luan **MATA**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**

Nr. 7722 Rep  
Nr. 899 Kol

#### VERTETIM NENSHKRIMI

Sen me date 01.09.2006 (dymije e gjashte ) para meje notere Shkendie **SHAHU**, me sen ne rrugen e "Durrresit" u paraqit personalisht shtetasi Luan **MATA**, me identitetin e tije u sigurova nga pasaporta personale Z. 1577380. Ne moshe madhore, me zotesi te plote juridike edhe per te vepruar, i cili deklaroi se ne Statutin e shoqerise tregtare "**Hotel - VICTORIA**" sh.p.k. si me lart shprehet vullneti i tije i plote dhe i lire dhe e firmosen ate para meje, ku une noterja e vertetoj sipas ligjes.

